



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural**  
**Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja**  
**Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development**

**Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister**

|   |            |
|---|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO |            |
| QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO     |            |
| MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL      |            |
| MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA    |            |
| MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT     |            |
| Arkivi Qendror - Centralno Arhivo - Central Archive         |            |
| Nr./Br./No.   | 3299       |
| Nr. i fq./Dr. Str./No. pg.                                  | 3          |
| Data/Datum/Date   | 10.08.2023 |
| PRISHTINE PRISTINA PRISTINA                                 |            |

Datë: 08.08.2023

Ref. KM-275/23

Në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/ 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) neni 15, Shtojca 11 të Rregullores (QRK)-Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (30.03.2021), dhe Nenin 20 (paragrafët 1, 4 dhe 5) të Ligjit Nr. 03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, (Gazeta Zyrtare Nr. 44, datë 22.12.2008) si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit për vlerësim dhe autorizim të Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, me Ref.04-382/23, të datës 31.07.2023, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nxjerrë:

**VENDIM**

**Për futjen në regjistër dhe lejimin e autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve për përdorim**

**1. Lejohet** importimi, vendosja në treg dhe përdorimi i autorizimit të produktit për mbrojtjen e bimëve –Domark 100 EC i prodhuesit “Gowan Crop Protection Limited”, United Kingdom nga përfaqësuesi i saj “Agronomi Group” SHPK, Suhareke.

**2. LLOJI I PRODUKTIT:** Fungicid

**3.PËRMBAJTJA E SUBSTANCËS AKTIVE:** Tetraconazole.....100g/l

**4. PËRDORIMI:**

Domark 100 EC është një fungicid me veprim sistematik triazol me një game të gjere të parandalimit kuruese dhe funksionim të radioaktiv.

1). **Ne vreshta**, për kontrollin e hirit të rrushit(Uncinula necator) në një doze prej 0,30 L/ha apo koncentrat 0,030%.Eshte e rekomanduar për përdorim në fazën fonologjikë të dukurisë kabranove

(BBCH61)ne fillim te pjekjes(BBCH 81) ne interval kohor prej 10 deri ne 14 dite.  
2).Ne **molla**, për kontrollin e hirit te mollës (Podosphaera leucotricha) ne një doze prej 0,40L/ha me një funksionim te pjesshëm kundër kromës se mollës(Venturia inaequalis). Ne rekomandojmë me përdorimin e fazave fonologjike ne përfundim te lulëzimit(BBCH 69) ne fillim te pjekjes(BBCH 75) ne interval kohor prej 7 deri ne 14 dite.  
Produkti ne te njëjtën parcelë mund te trajtohet deri ne tri here ne një sezon ne rritje.

**5. SASIA E AMBALAZHIMIT PËR IMPORTIM:**  
**0.10-0.25-0.5-1-5L**

**6.VËREJTJE:**

Domark 100 EC është toksik për organizmat ujorë dhe mund të shkaktojë efekte afat gjatë negative në mjedisin ujor. Gjatë punës duhet siguruar që produkti mos të vijë në kontakt me sy, lëkurë.

**7. KARENCA:**

Hardhia e rrushit është 30 dite, molla 14 dite

**8. PROPOZIMI I KLASIFIKIMIT:**



**GHS07-** ngacmues, irritues (cat 2 ose 3)



**GHS08-i** dëmshëm për shëndetin



**GHS09-paralajmërim**(cat 1)-i rrezikshëm për ambient

**9. VENDI I SHITJËS:** Në tërë territorin e Republikës së Kosovës

**10.** Produkti për mbrojtjen e bimëve i autorizuar nga pika 1 e këtij vendimi lejohet të importohet në Republikën e Kosovës, deri në afatin siç është përcaktuar në certifikatën e regjistrimit, duke u bazuar ne Databazën e Pesticideve te BE-se/Substancave aktive, ndërsa qarkullimi dhe përdorimi i tij lejohet sipas nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit Nr.03/L-042 i Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve.

11. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Faton Peci

Ministër

Vendimi i dërgohet :

- Komisioni për vlerësimin dhe autorizimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- DPMB;
- Shërbimi kufitar fitosanitar;
- Inspektorët fitosanitar AUV;
- Importuesit e produkteve për mbrojtjen e bimëve;
- Arkivi